



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Ftesë për propozime

12 dhjetor 2012, Prishtinë

Bazuar në mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, MAPL, fton Organizatat Jo-qeveritare-të që të paraqesin propozimet e tyre për realizimin e fushatës informuese që do të përfshijë dy komponentë të rëndësishme të komunikimit:

Informimi i qytetarëve për procesin e vendimmarrjes në Komuna

Informimi i qytetareve për mundësinë e përcjelljes on-line të asamblesë komunale

Nëpërmjet kësaj ftese, MAPL fton të gjitha organizatat jo-qeveritare që të paraqesin propozimet e tyre, për të aplikuar për këtë grant duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim

Kriteret për Aplikim për OJQ-të:

Kërkesat (Projekt propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt propozimin që përfshinë qëllimin e projektit dhe aktivitetet;
2. Buxhetin e detajizuar si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin e precizuar kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detajizuar të përfituesve dhe pjesëmarrësve;
5. Përshkrimin e detajizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës (përfshirë personelin, pajisjet dhe aftësinë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj);
6. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
7. Referencat nga projektet e ngjashme;
8. Aplikantët duhet të kenë xhirologari në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qëndrore e Kosovës.

Më datë 13.12.2012 në ora 10:30 në Ndërtesën e MAPL-së (Ish pallati i Rilindjes) kati i XIII -të do të këtë takim informues me OJQ-të e interesuara për aplikim ku do të jepen informata lidhur me këtë grant.

Data e fundit për dorëzimin e projekt propozimeve është data 20 dhjetor 2012. Aplikacionet duhet të dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Ish pallati i Rilindjes) kati i XII-të dhe në zarf të mbyllur të shënohet për: Departamentin për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal.